



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR KOMUNITETE

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 06 mars 2020, në mbledhjen e XXI-të (njëzetënjë) të Komitetit për Komunitete, mandati VI.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 52-ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 13:35.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Albina Avdiu Kryesuese e Komitetit,

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu-Podvorica, Benjamin Ejupi, Bashkim Sylja, Doruntina Hasani, Valmire Lahu ndërsa munguan Mefail Rama dhe Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin, Liman Zeqiri, shëf i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Arbresha Bashota zyrtare nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Podujevë, Bashkim Bajrami nga Policia Kufitare, Elisabeth Reimers, Maja Lehner dhe Bekim Karaxhija përfaqësues nga OSBE-së.

Rendi i ditës

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe duke iu uruar mirëseardhje, shtoi, thirrjen dhe materialin e rendit të ditës e keni marrë me kohë, andaj nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës urdhëroni, nëse jo e hedh në votim rendin e propozuar të ditës.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

1. Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Komitetit të mbajtura më: 22 janar 2020 dhe 12 shkurt 2020

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime u miratuan Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 22 janar 2020 dhe 12 shkurt 2020.

2. Informatë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, rreth gjendjes socio-ekonomike të Komuniteteve Rom, Ashkalinj dhe Egjiptas, me theks të veçantë gjendja e banimit.

znj.Arbresha Bashota, zyrtare në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, e paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, si zyrtar të DSHMS-së po thujse për çdo ditë jemi në terren dhe bëjmë vizita varësisht kërkesave të palëve, të cilat kryesisht janë për përmirësimin e kushteve të banimit, për ndërtime të shtëpive, kërkesa këto të cilat bëhen nga banorët e Komunës së Podujevës në përgjithësi.

Në vitin 2019 kemi pas 30 kërkesa për ndërtim të shtëpive, por pavarësisht kësaj ne kemi bërë edhe më shumë vizita në familjet të cilat kanë nevojë për ndërtimin e shtëpive të reja për shkak të gjendje së rënë ekonomike sociale dhe të banimit, rreth 60-70 familje, kjo për arsye se kemi informata dhe lajmërimi nga përfaqësuesit e fshatrave por edhe ata të lagjeve dhe me këtë rast ne edhe përkundër që nuk ka kërkesa të tilla nga ato familje, sipas detyrës zyrtare dalim i vizitojmë dhe shohim gjendjen e tyre nga afër, hartojmë procesverbal, marrim historiatin e gjendjes familjare të tyre, fotografi dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me nevojat e tyre.

Problemi qëndron në mungesën e buxhetit për këtë çështje dhe nuk po mundemi t'i ndihmojmë sa duhet. Pavarësisht kësaj kemi një familje të cilës Komuna i paguan qiranë e banimit që rreth 1 vit, pastaj kemi tri familje të cilat do t'iu ndërtohen shtëpitë e reja në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse dhe Grupin e Deputetëve 6+ e që tani e kemi miratuar dhe jemi në përfundim e sipër të proceduarave dhe vetëm pritet të fillojnë punimet, përkatësisht 1 shtëpi do të filloj tani sepse është dashtë të pritet të rregullohet rruga sepse nuk ka qenë e rregulluar. Pastaj kemi 29 kërkesa për përmirësim të kushteve të banimit me (dritare, dyer, dysheme etj.) të cilat janë vetëm të evidentuara sepse nuk kemi kapacitete buxhetore për t'i ndihmuar tani për tani. Mandej kemi disa programe për subvencione me barna për ato raste që aplikojnë dhe kemi rreth 12 familje dhe atë konform rregullave ligjore që është 1 herë në vit. Gjithashtu në bashkëpunim me donator të ndryshëm kemi shpërndarë pako ushqimore, dru për ngrohje, veshmbathje dhe gjëra tjera varësisht mundësive për familjet e komuniteteve jo shumicë.

Pra kjo ishte një informatë e shkurtër rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Bashkim Sylja, theksoi, dëshiroj të paraqes 3 pyetje rreth kësaj çështjeje. Kërkesat që u cekën nga parafolësja, a bëhet fjalë vetëm për komunitetet jo shumicë që janë zyrtare kërkesa të përgjithshme, apo janë kërkesa të përgjithshme.

Pastaj u tha se janë duke u ndërtuar 3 shtëpi në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse dhe Grupin e Deputetëve 6+, e them këtë ngase ne kemi qenë të informuar për vetëm 2 shtëpi, pra a do të thotë se 1 shtëpi do të ndërtohet në këtë vit. Si dhe a keni ndonjë statistikë se sa fëmijë të komuniteteve RAE janë me nevoja të veçanta.

znj.Arbresha Bashota, zyrtare në DSHMS, përgjigje, po kërkesat janë vetëm për komunitete jo shumicë dhe shumica e tyre janë zyrtarisht të proceduara në Komunë.

Çështja është se fillimisht është bërë miratimi për ndërtimin e dy shtëpive, pastaj sërish kemi pas mundësi të ri shqyrtojmë këtë plan dhe kemi arritur të jemi përfitues edhe të 2 shtëpive tjera. Konkretisht 3 prej tyre janë vetëm në përfundim e sipër vetëm ka mbete rryma e të tjera të ngjashme, kurse 1 do të filloj shumë shpejt për arsye se është dashtë të pritet deri sa të rregullohet rruga. Pra lejet ndërtimore janë dhënë, dhe jemi në gatishmëri për fillimin edhe të shtëpisë së katërt konkretisht për familjen e cila jeton tek hekurudha në Podujevë e të cilës i është dhuruar një parcelë në fshatin Dumosh, familje të cilës iu kemi ndihmuar shumë herë me gjëra të ndryshëm, qoftë pako ushqimore dhe hixhienike, veshmbathje, etj sepse vërtetë janë në gjendje të rëndë

ekonomike dhe sociale por edhe shëndetësore sepse disa prej anëtarëve janë të sëmurë, madje kemi bërë edhe bartjen e fëmijëve në shkollë sepse ka që janë me aftësi të kufizuara.

Statistika të veçanta rreth fëmijëve të komuniteteve jo shumicë që janë me nevoja të veçanta, nuk kemi por ka disa raste të cilat vazhdimisht ju jepet ndihmë nga ana e Komunës.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësit për kontributin dhe sqarimet e dhëna, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën e konstatojmë të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës dhe kalojmë në pikën e radhës.

3. Raporti i Punës së Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim për vitin 2019

z.Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim – ZKKK, e paraqiti raportin në fjalë, ndër të tjera theksoi, edhe pse raporti ju është dërguar dhe e posedoni të gjithë e i cili është paksa voluminoz, unë sërish këtu do të paraqesë në pika më të shkurtra çështje që ndërlidhen me raportin, aktivitetet dhe çështje tjera rreth ZKKK n'raport me komunitetet jo shumicë, pa përjashtuar edhe çështje tjera që ndërlidhen në përgjithësi.

Normal që është një proces i ZKKK ku edhe vetë referati i saj është të merret me komunitete, kthim, prona, por edhe me riatdhesim si punë shtesë që na është ngarkuar nga ana e nivelit qendror e që mund të themi se është një punë paksa voluminoze qoftë sa i përket terrenit qoftë aspekte tjera, por megjithatë deri në një masë kemi arritur t'i përmbushim kërkesat që edhe janë detyrë e ZKKK-së.

Procesi i kthimit është një proces i cili vazhdon, dhe ne vazhdimisht bashkëpunojmë edhe me Organizata Ndërkombëtare të cilat merren drejtpërsëdrejti me këtë proces. Në vitin 2019 nuk kemi pasur ndonjë kërkesë për dallim nga vitet e kaluara e që ne si ZKKK jemi të obliguar të dalim në terren, të verifikojmë gjendjen reale të pronave e që në shumë raste ne duhet të bashkëpunojmë edhe me organet e drejtësisë rreth pronave eventualisht të uzurpuara që ato të lirohen dhe normal edhe gjendja e tyre përshkruhet në bashkëpunim me Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë sa i përket hartave, dhe dokumenteve tjera shtesë të nevojshme lidhur me vendbanimet ku kanë jetuar të kthyerit, kjo ngase mund të ketë ende prona të uzurpuara dhe në atë gjendje siç kanë qenë të personave të zhvendosur nga territori i Komunës së Podujevës, por që në vitin 2019 nuk kemi pasë kërkesa të tilla. Megjithatë ne këtë proces e mbulojmë por ajo që është edhe një proces shtesë është edhe riatdhesimi e që jemi në dijeni besoj se që 28 korriku 2010, personat që migrojnë e që ende vazhdon, por edhe persona që kanë qenë ndoshta edhe me vite të tëra 20 - 30 vite më parë të cilët nuk kanë mundur ta rregullojnë statusin e tyre rreth qëndrimit në ato shtete që jetojnë, me theks në vendet e Bashkimit Evropian, normal që është proces që ata persona kthehen në bazë të një Memorandumi të Mirëkuptimit mes Republikës së Kosovës dhe shteteve përkatëse, që ata persona që kthehen/riatdhesohen ne duhet të merremi me ata në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi që kemi si Komunë dhe si shtet në përgjithësi, ku fillimisht trajtohen dhe evidentohen në aeroport, pastaj përcjellën në Komunën ku kanë jetuar e që pastaj kemi komisionin komunal për riintegrimin e personave të riatdhesuar i cili shqyrton gjendjen e tyre dhe çështje tjera sipas detyrave dhe përgjegjësi të nivelit lokal ngase më shumë janë ato të nivelit qendror varësisht fushës së Ministrive ngase kanë edhe buxhet për këtë proces, por që ne si komision kemi edhe kompetencat tona siç janë siguri i banimit përmes qirasë e cila paguhet nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me Qendrën për Punë Sociale dhe Zyrën e Punësimit, pastaj është ndihme me pako për dimër e cila trajtohet në kohë dhe sezone, është edhe trajtimi mjekësor ngase ka shumë raste të cilat vijnë me sëmundje të

ndryshme e që ne si Komunë e kemi për obligim t'jua lehtësojmë me kompensimin e shpenzimeve për barna.

Pastaj është edhe rindërtimi dhe renovimi i shtëpive, mandej ndihma për personat e cenueshëm e që ne si komision i trajtojmë por që mund të themi se për ne si Komunë është një fat i madh sepse nuk kemi shumë raste sa i përket strehimit apo banimit që është afat 6 deri në 12 muaj, por që po thuajse shumica prej tyre gjenden e tyre reale e kanë të zgjidhur dhe nuk paraqiten nevojat për një gjë të tillë sepse kanë prona banimi por që kanë dalë ndoshta për një jetë më të mirë, e që edhe sot ka një migrim të tillë për këtë arsye.

Në 2019 janë kthyer 103 persona, 60 prej tyre familjarë, 40 persona individual, prej tyre 19 nxënës e për të cilët si proces kemi edhe shkollimin intensiv me të cilët merren Ministria e Arsimit dhe Drejtoria e Arsimit e Komunës së Podujevës, 3 familje kanë qenë përfutuese të strehimit të përkohshëm, 2 familje kanë qenë përfutuese të trajtimeve mjekësore dhe me medikamente, 2 familje kanë përfutuar pako dimërore, 3 familje kanë përfutuar orendi shtëpiake dhe 3 familje kanë hyrë në asistencë sociale (natyrisht raste sipas kriterit për ato familje që kanë fëmijë deri në moshën 5 vjeçare dhe që nuk kanë asnjë ndihmë) raste këto të cilat trajtohen përmes Komunës.

Pastaj ne kemi bashkëpunim edhe me disa Organizata ndërkombëtare UNDP, URA, Organizata e Nurenbergut, etj të cilat merren me këto çështje ku shumë persona shkojnë dhe kryejnë trajnime dhe kurse të ndryshme për përfitim për biznese në bazë të projekteve të tyre dhe pas shqyrtimit të tyre ka prej atyre që përfitojnë qoftë nga Organizatat ndërkombëtare qoftë nga buxheti i nivelit qendrorë në mënyrë që të rigjenerojnë të hyra për familjet e tyre por edhe brenda mundësive edhe të punësojnë ndokënd.

Kemi pas një informatë edhe për Arsim, por dëshiroj të ceku sërish se ashtu siç jemi në dijeni në Komunën e Podujevës nuk mund të themi se ka ndonjë diskriminim sa i përket nxënësve në të gjitha shkollat ku vijojnë mësimin edhe fëmijët e komuniteteve jo shumicë ku nuk kemi pas asnjë cenim apo ndonjë të padrejtë dhe për këtë falënderoj të gjithë pa dallime. Mirëpo nganjëherë mund të themi se ka një rënie të vijueshmërisë në shkolla qoftë nga komuniteti shumicë qoftë nga ai jo shumicë, kryesisht nga vendet rurale e që mund të themi se kjo si pasojë e migrimit në vendet tjera. Sa për statistika, në vitin 2019 kanë qenë 156 nxënës të komuniteteve jo shumicë, prej tyre 27 në shkollimin e mesëm e që krahasuar me vitin e mëparshëm kemi rënie sepse kanë qenë 34 nxënës ashtu sikurse që kemi rënie edhe tek numri i studentëve sepse në vitet e kaluara ka pasë nga 7-8 student kurse tani kemi vetëm 4 prej tyre dhe kjo vërejtje edhe nga nataliteti por edhe nga migrimi për shkak të çështjeve sociale ekonomike edhe pse gjithëherë kemi insistuar dhe iu kemi ndihmuar qoftë me bursa qoftë në aspekte tjera bashkërisht edhe me Organizata vendore dhe ndërkombëtare, ndër të tjera është OJQ Voice of Roma e cila përveç bursave organizon edhe 2 paralele mësim shtesë intensiv për nxënësit e komuniteteve jo shumicë, dhe në këtë aspekt kemi bërë kërkesë që në lagjen "Ali Ajeti" ta kenë një shkollë me qëllim të tretmanit dhe komoditetit sa më të mirë të atyre nxënësve, por prap si Arsim ka shqetësime në kuptimin ekonomik social por normal edhe migrimi që e ceka, mirëpo ne do t'i qasemi kësaj çështjeje sepse është shtylla kryesore e jona dhe e shoqërisë në përgjithësi.

Sa i përket shëndetësisë mund të themi se kemi një rrjet dhe strukturë të mirë të shëndetësisë në Komunën e Podujevës ku vazhdimisht bëhen investime qoftë në objekte qoftë në pajisje dhe çështje tjera dhe jemi në pritje të funksionalizimit të Spitalit të Përgjithshëm nga ana e Qeverisë qendrore, andaj mund të them se trajtimet shëndetësore bëhen të barabarta për të gjithë qytetarët pa dallime. Pra sa i përket shëndetësisë këto janë mundësitë tona çka mund të bëjmë qoftë në aspektin buxhetor qoftë në aspektin e kapaciteteve, intelektuale, civilizuese dhe qytetëruese në përgjithësi që kemi si Komunë e që për këtë krenohemi të gjithë edhe për faktin që jemi Komuna më e qetë në

Kosovë sa i përket bashkëjetesës me komunitetet e që mund ta nënvizojmë se që 20 vite pas luftës nuk kemi asnjë eksces ndëretnik.

Shqetësuese mbeten ende punësimi dhe mirëqenia sociale, por duhet ta pranojmë që jemi duke jetuar në trendin e ri jetësor dhe shtetëror që janë kapitalizmi dhe privatizimi dhe tani nuk kemi punësim ashtu siç ka qenë në ish sistemin ku ka pas organizata apo fabrika shtetërore, por tani më shumë kemi orientim në institucione private, por kemi edhe në institucione publike që punësimet bëhen në bazë të konkurseve dhe natyrisht kërkohen kuadro dhe kualifikime përkatëse, megjithatë kemi një ngritje prej viteve tjera sa i përket numrit të të punësuarve nga radhët e komuniteteve jo shumicë. Ne kemi edhe numrin e atyre që janë të regjistruar për punësim në Zyrën e Punësimit, por ai numër nuk mund të them se është krejt real për shkak se ka lëvizje të herë pas herë dhe ata numra mund të ndryshojnë, mirëpo nëse flasim për gjendjen ekonomiko sociale, në bazë të të dhënave të Qendrës për Punë Sociale, jemi në dijeni se kemi 69 familje nga komuniteti ashkalinj me 453 anëtarë, dhe 4 familje të komunitetit rom me 36 anëtarë, por që punësimi i tyre nuk mund të them se është i kënaqshëm, mirëpo këto familje gjithnjë janë në rritje lindjeve dhe shumica prej tyre janë me asistencë sociale e që edhe për këtë nuk mund të them se është një gjendje e mirë.

Sa i përket banimit dhe infrastrukturës mund të them se është në nivel sepse në të gjitha ato lagje ku jetojnë komunitetet jo shumicë ka pas investime të barabarta me ato që bëhen në përgjithësi, por ajo që mund të quhet shqetësuese janë kërkesat për ndërtimin e shtëpive të banimit dhe për strehim, por që kërkesa të tilla ka edhe nga komuniteti shumicë dhe normal që ne të gjitha ato i shqyrtojmë dhe kërkojmë edhe donatorë të ndryshëm për një gjë të tillë. Jemi në dijeni se në vitet e mëhershme Komuna ka pas projekt për ndërtimin e shtëpive, nga 10 në vit, por që ka pas edhe donacione nga donatorët, por megjithatë kërkesa të tilla ende ka, mirëpo ajo që paraqitet si problem dhe të cilën çdo herë e kam ngritur është çështja e pronave e cila është e ndjeshme por që kërkohet, madje edhe me dokumentacion, për të ndërtuar një shtëpi. Vlen të theksohet dhe të falënderohet Grupi i Deputetëve 6+ që kanë ndarë buxhet për ndërtimin e 4 shtëpive për familjet e komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës, po ashtu edhe OJQ-në Bereqeti e falënderojmë për ndarjen e një prone në fshatin Dumosh për ndërtimin e një shtëpie për familjen e Alushi e cila për momentin është duke jetuar tek hekurudha, e cila ka një numër të madh të anëtarëve, 17 anëtarë dhe disa prej tyre janë të sëmurë. Pra sinqerisht ju them se asnjëherë Komuna nuk ka hezitur por më shumë ka qenë problem çështja e pronës, por legalizimi i pronave ende është në proces dhe shpresoj se do t'i rregullojnë ato çështje dhe pastaj do të jetë më e lehtë të ndihmohen.

Pastaj kemi mediat, kulturën, rinin dhe sportin, jemi në dijeni që tani kemi edhe TV Llapi i cili ka të ndarë një program special për komunitetet dhe është gjë e mirë sepse çdo herë kur ka lajm, aktivitete apo ndonjë reportazh, të gjithë mund të jenë të informuar dhe më e lehtë deri tek komunikimi. Për kulturë rini dhe sport, ne tani jemi në dijeni për privatizimin e sportit dhe të gjithëve iu mundësohet ta shprehin talentin e tyre në sporte të ndryshme dhe janë të mirëseardhura këto. Sa i përket përfaqësimit të komuniteteve, jemi në dijeni se anëtari i këtij Komuniteti Radisav Perović i cili është me prejardhje malazeze, por që gjithherë është konsideruar si përfaqësues i komunitetit serb, tani nuk jeton në territorin e Komunës së Podujevës por është bartur në Medvegj, por që nganjëherë vjen verës në fshatin Metergoc, natyrisht se kam qenë në kontakt me atë por që ndoshta edhe për shkaqe shëndetësore dhe të moshës që ka zgjedh Medvegjën. Gjithashtu mund të themi se jemi të kënaqur me përfaqësimin gjinor në këtë Komitet por edhe në organe tjera përkatëse, me theks mburrim me përfaqësimin gjinor në këtë Komitet sepse janë më shumë femra dhe kjo na bënë të ndihemi mirë, dhe ju jam shumë falënderues për bashkëpunim duke shpresuar në vazhdimësinë e këtij bashkëpunimi me të gjithë pa dallime.

Po ashtu jam falënderues edhe ndaj Organizatave siç është OSBE e cila gjithherë na ka ndihmuar, këshilluar, trajnuar, hartim të planeve, me projekte të ndryshme, etj, dhe ju jemi mirënjohës.

Ndoshta paksa e zgjata diskutimin tim, ndoshta edhe nuk munda t'i paraqes të gjitha, mirëpo gjitha informatat tjera besoj se i keni lexuar në Raportin që ju është dërguar.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, e falënderoj parafolësin z.Liman Zeqiri për informatën, sqarime dhe gjitha çështjet tjera që i potencoj dhe çështjet tjera që janë të potencuar në raportin përkatës.

z.Bashkim Sylja, theksoi, natyrisht se na takon edhe neve si Komitet të falënderojmë për bashkëpunim Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Sa i përket banimit social për vitin 2019, në raportin në fjalë, në faqe 17, thuhet se Komuna ka hequr nga programi i ndërtimit të shtëpive për raste sociale.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, përgjigje parafolësit, theksoi, tek ne nuk ka banim social, por në shumë komuna të Kosovës ka banim social apo siç mund të quhet banim kolektiv. Pra në Komunën tonë nuk kemi të tillë ngase asnjëherë nuk ka pasur diçka të tillë që kanë banuar në kuptimin e asaj që ka qenë banesë e rasteve sociale ashtu siç i kanë Prishtina, Lipjani etj. Ndërsa sa i përket asaj që iu referua parafolësi, Komuna e Podujevës këtë projekt, me atë titull e ka heq nga programi që nga viti 2014, për shkak të mjeteve buxhetore.

znj.Arbresha Bashota, zyrtare nga DSHMS, theksoi, ashtu siç e ceku shefi i ZKKK-së, Komuna e Podujevës nga viti 2014 e ka hequr projektin e tillë për ndërtimin e shtëpive sociale që ka qenë, por tani kjo realizohet vetëm përmes donatorëve ku deri tani, nga ajo periudhë janë ndërtuar 14 shtëpi për raste sociale.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, pyetje për shefin e ZKKK-së, theksoi, u cek që përmes Organizatës ndërkombëtare Voice of Roma, organizohet mësim shtesë intensiv për nxënësit e komuniteteve jo shumicë, kurse sa jam në dijeni, para disa ditëve ka pas një kërkesë për një Marrëveshje Bashkëpunimi për financim nga ana e Komunës, prandaj dëshiroj të dijë deri ku ka shkuar kjo kërkesë dhe ky proces.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, përgjigje parafolëses, theksoi, ne çdo herë kemi marrëveshje të tilla për bashkëfinancim, dhe ajo Organizatë ka buxhetin e vet për këtë çështje, mirëpo ka pas një kërkesë për një objekt shkollor në lagjen “Ali Ajeti”, ngase ne jemi në gjendje për ato ambiente ku zhvillojnë atë mesazh shtesë. Në këtë kontekst ne i kemi bërë kërkesë Drejtorisë së Arsimit për gjetjen e një hapësire të nevojshme dhe të përshtatshme, ndërsa ajo Organizatë çdo herë ka pas buxhetin e vet dhe kan financiar, por natyrisht edhe ne si Komunë, si Drejtori e Arsimit çdo herë iu kemi dal në ndihmë.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësit për kontributin, nëse nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, e konstatoi të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

4. Të ndryshme

Meqë nuk pati diskutime tjera, Kryesuesja e Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr. 01-060/04-0020361/20

Podujevë,

06 mars 2020

Kryesuese e Komitetit

Albina Avdiu